



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



N.P.SH. "ARTMOTION"
Nr. i biznesit 80660529
Pronar – Muharrem HAJREDINI
N.P.SH. Artmotion
Rr/Hajdar Dushi, 1A/2
Prishtinë

"ARTMOTION" SH.P.K
Nr. i biznesit 71364887
Pronar – Valon SHALA
Artmotion SH.P.K.
Rr/ Lidhja e Pejës, Zona Industriale
Prishtinë

Ref:1710/1214/LIC/ni

VENDIM

për ndryshimin pronarit si person fizik si dhe ndryshimin e licencës së operatorit të shpërndarjes N.P.SH. Artmotion në "Artmotion" SH.P.K. sipas ndryshimeve në llojin e biznesit

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. N.P.SH. Artmotion është Operatorë i Shpërndarjes i licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për shpërndarjen e ofruesve të shërbimeve mediale audiovizuale në pajtim me Rregullorën KPM – 2016/01. N.P.SH. Artmotion është pajisur me licencë të KPM-së më datën 30 tetor 2013.
3. Më datën 25 shtator 2017, pronari i N.P.SH. Artmotion, ka dorzuar një kërkesë në zyrën e KPM-së, me anë të së cilës ka kërkuar miratimin e KPM-së për ndryshimin e pronarit si person fizik dhe kalimin e pronësis nga z. Muharrem Hajredini tek z. Valon Shala si dhe ndryshimin e licencës të operatorit të shpërndarjes, sipas ndryshimeve të llojit të biznesit, nga N.P.SH. "Artmotion" në "Artmotion" SH.P.K, ku përveç numrit të ri të biznesit, figuron edhe numri i vjetër i biznesit.

Arsyetimi


4. Neni 21, paragrafi 3 i Ligjit të KPM-së përcakton se: “licencat nuk mundë të shfrytëzohen dhe bartën pa autorizim dhe pa aprovim paraprakë me shkrim të KPM-së”.
5. Komisioni konstaton se, pala e interesuar ka dorëzuar dokumentet dhe informacionet e nevojshme lidhur me kërkesën për ndryshimin e pronarit, si person fizik, si dhe ndryshimin e licencës së KPM-së. Gjthashtu, parashtruesi i kërkesës ka kryer edhe pagesën e tarifës administrative për ndryshime në licencë, në vlerë prej njëqind (100.00) euro, në pajtueshmëri me Rregulloren për Tarifën Vjetore të Licencës (KPM -2017/03).
6. Komisioni e konsideron se, kërkesa është parashtruar në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së dhe si e tillë i plotëson kriteret për miratim.

Vendim

7. Komisioni, në takimin e mbajtur më datën 22 nëntor 2017, merr vendim për miratimin e kërkesës së operatorit të shpërndarjes për ndryshimin pronarit si person fizik, të operatorit të shpërndarjes N.P.SH. Artmotion duke e kaluar pronësinë nga z. Muharrem HAJREDINI tek z. Valon SHALA, si dhe ndryshimin e licencës sipas ndryshimeve të llojit të biznesit, nga Biznesi Individual N.P.SH. “Artmotion” me numër 70880954, në biznesin si Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar “Artmotion” SH.P.K. me numër 71350703.

Lëshimi i Vendimit

8. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit.


Adnan MEROVCI

Kryetar

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE



24.11.2017
datë